



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
**Autoriteti Kosovar i Konkurrencës**  
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

---

Në bazë të nenit 28 paragrafi 1.1, të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Ligji nr. 03/L-229, (Gazeta zyrtare nr. 88, dt. 25.11.2010) si dhe neni 4 dhe 7A, paragrafi 2 i Plotësim Ndryshimit të Ligjit 04/L-226 Komisioni i Autoriteti Kosovar i Konkurrencës me **dt. 21.11.2017** nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR. 05/2017**  
**Për përjashtimet grupore të marrëveshjeve në sektorin e sigurimeve**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**  
**Objekti i Rregullores**

**Neni 1**

Me këtë Udhëzim administrativ përcaktohen kushtet të cilat duhet ti përmbushin marrëveshjet e sigurimeve, si dhe kufizimet ose kushtet që këto marrëveshje nuk mund ti përmbajnë, në mënyrë që të jenë në gjendje të përjashtohen në formë grupore nga ndalimi i përgjithshëm sipas nenit 4 të ligjit nr. 03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës ( në tekstin e mëtejshëm Ligji).

**[Kuptimi i koncepteve (emërtimeve)]**

**Neni 2**

Për qëllimet e këtij udhëzimi administrativ termat e caktuar e kanë kuptimin e mëposhtëm:

a) **Marrëveshja** është kontratë, dispozitë e veçante e kontratës, marrëveshjet gojore ose me shkrim të formuluar ndërmjet kompanive të sigurimeve si dhe praktikave të bashkërenduara të cilat burojnë nga këto marrëveshje, vendimet e kompanive të sigurimeve ose të unioneve të kompanive të sigurimeve, kushtet e përgjithshme të afarizmit dhe aktet e tjera të kompanive të sigurimeve të cilat janë ose mund të jenë pjesë e kontratës dhe të ngjashme, pavarësisht nga fakti nëse marrëveshjet e tilla janë të lidhura në mes të dy ose më shumë kompanive të pavarura të sigurimeve të cilat veprojnë në të njëjtin nivel të shërbimit të sigurimit (marrëveshjet horizontale) ose në mes të dy ose më shumë kompanive të pavarura të sigurimeve të cilat nuk operojnë në të njëjtin nivel të shërbimit të sigurimit (marrëveshjet vertikale);

b) **Produktet** janë shërbimet e sigurimit;

c) **Subjekti Afarist (Kompania e sigurimeve)** sipas nenit 3 paragrafi 1.9 e ligjit nr.03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës është personin fizik ose juridik, që është i regjistruar dhe kryen veprimtari të sigurimit.

d) **Kompania e sigurimeve nën kontroll të kompanisë tjetër të sigurimeve ose kompania e përqendruar** ( Ndërmarrje nën kontroll të ndërmarrjes tjetër ose ndërmarrja e përqendruar) krijohet sipas nenit 13 paragrafi 1 pika 1.2 e Ligjit nr.03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës nëpërmjet të kontrollit të drejtpërdrejt apo të tërthortë ose me ndikimin e pozitës dominuese të një apo më shumë ndërmarrjeve (kompanive të sigurimeve) apo pjesëve të ndërmarrjeve (kompanive të sigurimeve).

e) **Tregu relevant** sipas nenit 3 paragrafi 1 pika 1.8 e Ligjit nr.03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës përfshinë fushën e aktivitetit të sigurimit për të cilën konkurrenca është e kufizuar në një zonë të caktuar gjeografike, duke përfshirë të gjitha produktet dhe shërbimet e zëvendësueshme për të cilat klientët mund të drejtohen në afat sa më të shkurtër, në rast se kufizimi apo abuzimi rezulton në ngritjen e çmimit;

(f) **AKK - Autoriteti Kosovar i Konkurrencës** që është themeluar me ligjin nr.03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës në tekstin e mëtejme (Autoriteti).

## **Marrëveshjet për të cilat zbatohet përjashtimi grupor**

### **Neni 3**

(1) **Përjashtimi grupor** i referuar në nenin 4, paragrafi 3.1 të ligjit nr.04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës zbatohet për **ujditë e sigurimit të arritura midis dy ose më shumë Kompanive të pavarura** në sektorin e sigurimeve me të cilat parashihen:

a) **Shërbimet e përbashkëta**, hartimi (nxjerrja) dhe mbledhja e të dhënave të duhura si dhe shpërndarja e tyre, të nevojshme për llogaritjen e kostos mesatare të shpenzimeve për mbulimin e një risku të caktuar në të kaluarën (në tekstin e mëtejme të dhënat përmbledhëse) mandej hartimi i tabelave të përbashkëta të vdekshmërisë si dhe tabelat të cilat tregojnë frekuencën e sëmundjeve, aksidenteve dhe invaliditetit lidhur me sigurimin të cilat e përfshijnë elementin e kapitalizimit ( akumulimit të kapitalit) në tekstin e mëtejme: **tabelat**,

b) **Kryerja e studimeve të përbashkëta** lidhur me ndikimin e mundshëm të rrethanave të jashtme në të cilat kompanitë e sigurimeve, pjesëmarrëse të marrëveshjeve nuk mund të ndikojnë në frekuencën ose përmasat e kërkesave të ardhshme për kompensim të dëmeve për një risk të caktuar ose kategori të riskut apo në rentabilitetin e llojeve të ndryshme të investimeve (në tekstin e mëtejme studimet), si dhe në shpërndarjen e rezultateve të studimeve të tilla.

(2) **Pjesëmarrës të marrëveshjeve të sigurimit** nga paragrafi 1 i këtij neni konsiderohen Kompanitë e sigurimeve si dhe subjektet e tjera të lidhura me to (brokerët – ndërmjetësuesit) dhe .

### **Marrëveshjet në të cilat nuk zbatohet përjashtimi grupor**

#### **Neni 4**

Sipas këtij Udhëzimi administrativ nuk mund të përjashtohen nga ndalimi i përgjithshëm i paraparë me nenin 4, paragrafi 3.2 të ligjit nr.04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës:

- (a) Marrëveshjet e sigurimit që nuk janë në përputhje me këtë Udhëzim administrativ,
- b) Marrëveshjet e sigurimit në të cilat ekskluzivisht zbatohen dispozitat e tjera për përjashtim grupor të paraparë me nenin 5, 6 dhe 7 të ligjit bazik (Ligjit nr.03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës).

## **II. KUSHTET TË CILAT MARRËVESHJA DUHET TI PËRMBAJË SI DHE KUSHTET E TJERA TË CILAT DUHET TË PËRMBUSHEN PËR TA GËZUAR TË DREJTËN E PËRJASHTIMIT GRUPOR**

### **Të dhëna përmbledhëse, tabelat dhe studimet**

#### **Neni 5**

(1) Përjashtimet grupore për kontratat e sigurimit të përmendura sipas nenit 3 paragrafi 1 i këtij udhëzimi administrativ zbatohen me kusht që të dhënat përmbledhëse dhe / ose tabelat:

- a) Të jenë të bazuara në informatat e mbledhura, të cilat janë të përndara në numrin e viteve të riskut dhe të cilat janë të përcaktuara ashtu që ta formojnë periudhën e caktuar në shqyrtim, dhe të cilat kanë të bëjnë me risqet e njëjta ose të krahasueshme si dhe janë në numër të mjaftueshëm për procesim (përpunim) statistikor, të cilat ndër të tjera, do të rezultojnë me të dhënat numerike lidhur me numrin e kërkesave për kompensim të dëmit gjatë periudhës së përmendur, me numrin e risqeve individuale të siguruara për çdo vit të riskut gjatë periudhës së vështruar, me shumën e përgjithshme të paguara ose me detyrimet e skaduar (të arritura për pagesë) të cilat kanë të bëjnë me kërkesat për kompensim të dëmeve të paraqitura gjatë kësaj periudhe si dhe me shumën totale të kapitalit për çdo vit të riskut gjatë periudhës së vështruar;

b) Të përfshijnë një përshkrim të hollësishëm të statistikave në dispozicion, në mënyrën më të përshtatshme aktuale ( të përcaktuara me metodat matematikore të probabilitetit dhe të algoritmeve) .

c) Nuk përmbajnë elemente për të dalurat (shpenzimet) e pa parashikueshme, të hyrat nga rezervimet, shpenzimet administrative ose të tregut apo kontributet fiskale ose jo fiskale (të cilat nuk i përfshijnë fondet qeveritare), të ardhurat nga investimet ose fitimi i pritur.

(2) Përjashtimet grupore për marrëveshjet e sigurimit nga neni 3 i këtij udhëzimi administrativ zbatohen me kusht që të dhënat përmbledhëse, tabelat ose rezultatet e studimit:

a) Nuk i përcaktojnë (nuk i emërojnë) siguruesit ose cilëndo shumë siguruese,

b) Gjatë mbledhjes (grumbullimit) dhe shpërndarjes e përmbajnë deklaratën se ato nuk janë të detyrueshme,

c) Nuk e përmbajnë dhe as nuk e përmendin bruto primin e sigurimit,

d) Janë në dispozicion nën kushtet adekuate dhe jo-diskriminuese për të gjithë siguruesit (kompanitë e sigurimeve) të cilat i kërkojnë ekzemplarët (kopjet) e tyre, duke i përfshirë edhe siguruesit të cilët nuk janë aktive në tregun relevant në kuptimin gjeografik apo të produktit me të cilin këto të dhëna përmbledhëse, tabela ose rezultate të studimit kanë të bëjnë.

e) Janë në dispozicion nën kushtet adekuate dhe jo-diskriminuese të shoqatave të konsumatorëve ose klientëve, të cilët për shkaqe të arsyeshme kërkojnë akses në këto informacione nën kushtet e caktuara dhe saktësisht të përmendura, përveç kur zbulimi (publikimi) i tyre do të ishte në kundërshtim me arsyet e sigurisë publike.

(3) Bruto primi nga paragrafi i 2-të i këtij neni është çmimi i cili i përlllogaritet blerësit të policës së sigurimit.

***Mbulimi i përbashkët i kategorive të caktuara të riskut, pjesëmarrja në treg dhe kohëzgjatja e përjashtimit grupor***

**Neni 6**

(1) Përjashtimet grupore të parashikuar me nenin 4, paragrafi 3.1 e ligjit nr.04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës sipas këtij të udhëzimit administrativ aplikohen edhe për marrëveshjet e arritura në mes të dy ose më shumë kompanive të sigurimeve për qëllime të krijimit dhe funksionimit të unioneve (fondeve të përbashkëta) të siguruesve ose të siguruesve dhe ri siguruesve të veprimtarisë së sigurimit për mbulimin e përbashkët të risqeve të kategorive të veçanta në formën e bashkë-sigurimit ose të bashkë-sigurimit të ri sigurimit.

(2) Me bashkimin (unionin) e bashkë-siguruesve (fondi i përbashkët) në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni konsiderohet unioni të cilin e themelojnë siguruesit, me përjashtim të marrëveshjeve ad hoc të bashkë sigurimit në tregun e mbulimit të dëmeve, me ç 'rast pjesën e caktuar të riskut e mbulon siguruesi kryesor kurse pjesën e mbetur të riskut e mbulojnë siguruesit e tjerë të cilët në atë moment ftohen për ta mbuluar këtë pjesë të mbetur, dhe të cilët bien dakord që në emër të gjithë pjesëmarrësve të bashkuar ti emitojnë policat e sigurimit për kategoritë e caktuara të riskut, apo t' ja besojnë emetimin dhe menaxhimin e policave të sigurimit të një kategorie të caktuar të riskut, në emër të tyre dhe për llogari të tyre, njërit nga siguruesit, një brokeri (ndërmjetësuasi) të përbashkët ose organit të përbashkët të themeluar për këtë qëllim.

(3) Me bashkimin (unionin) e bashkë-siguruesve të ri siguruesve sipas paragrafit 1 të këtij neni konsiderohet unioni të cilin e formojnë siguruesit, me ndihmën e mundshme të një ose më shumë ri siguruesve, me përjashtim të marrëveshjeve ad hoc të bashkë sigurimit të ri sigurimit në tregun e mbulimit të dëmeve, me ç 'rast pjesën e caktuar të riskut e mbulon siguruesi kryesor kurse pjesën e mbetur të riskut e mbulojnë siguruesit e tjerë të cilët në atë moment ftohen për ta mbuluar këtë pjesë të mbetur, me qëllim të ri sigurimit reciprok të gjitha detyrimeve të veta ose të pjesës së detyrimeve të veta ndaj riskut të kategorisë së caktuar, përkatësisht ashtu që në rastet e caktuara në emër të gjithë pjesëmarrësve dhe për llogari të tyre ta pranojnë ri sigurimin për kategorinë e njëjtë të riskut.

(4) Përjashtimi grupor për Unionet e bashkë siguruesve ose unionet e bashkë siguruesve të ri siguruesve nga paragrafi 1 i këtij neni, të cilat krijohen kryekëput për mbulimin e risqeve të reja, do të zbatohet për një periudhë prej tre vjetësh nga data kur unioni është themeluar së pari, pavarësisht nga pjesa e tregut të unionit (fondit të përbashkët).

(5) Përjashtimi grupor për unionet e bashkë-siguruesve ose unionet e bashkë-siguruesve të ri siguruesve të cilët nuk janë të përfshirë me paragrafin e 4 të këtij neni do të zbatohet për të gjithë kohën e zbatimit të këtij të udhëzimit administrativ, me kusht që pjesa e përbashkët e tregut të kompanive pjesëmarrëse nuk është:

a) më e lartë se 20% e pjesëmarrjes në cilin do treg relevant, në rastin e unionit të bashkë siguruesve

b) ) më e lartë se 25% e pjesëmarrjes në cilin do treg relevant, në rastin e unionit të bashkë siguruesve të ri siguruesve.

(6) Me qëllim të llogaritjes së pjesës së tregut të kompanive pjesëmarrëse të marrëveshjes në tregun relevant, në konsideratë merret:

a) pjesëmarrja në treg e kompanisë së sigurimeve e përfshirë në marrëveshje brenda unionit të caktuar,

b) pjesëmarrja në treg e kompanisë së sigurimeve e përfshirë në marrëveshje brenda ndonjë unioni tjetër, në tregun e njëjtë relevant në të cilin vepron edhe unioni në fjalë anëtar i të cilit është kompania e cila është nënshkruese e marrëveshjes.

c) pjesëmarrja në treg e kompanisë së sigurimeve e përfshirë në marrëveshje jashtë çfarëdo unioni në të njëjtin treg relevant ku vepron unioni në fjalë.

(7) Nëse pjesëmarrja e përgjithshme në treg e unionit të bashkë-siguruesve nga paragrafi 5, pika a) e këtij neni në momentin e arritjes së marrëveshjes nuk është më e madhe se 20% , por më vonë rritet në nivelin më të lartë se 20% e jo më shumë se 25% përjashtimi grupor vazhdon të zbatohet për një periudhë kalendarike prej dy vjet rresht pas vitit në të cilin për herë të parë është tejkualuar pjesëmarrja e tregut e nivelit 20%.

(8) Nëse pjesëmarrja e përgjithshme në treg e unionit të bashkë-siguruesve nga paragrafi 5, pika a) e këtij neni në momentin e arritjes së marrëveshjes nuk është më e madhe se 20%, por më vonë rritet në nivelin më të lartë se 25% përjashtimi grupor do të vazhdojë të zbatohet gjatë periudhës kohore prej një viti kalendarik pas vitit në të cilin për herë të parë pjesëmarrja në treg e unionit të bashkë-siguruesve është rritë në mbi 25%.

(9) përjashtimi grupor nga paragrafët 7 dhe 8 të këtij neni nuk mund të akumulohet në mënyrë që ta tejkalojë periudhën prej dy vjetëve kalendarik.

(10) Nëse pjesëmarrja e përgjithshme në treg e unionit të bashkë siguruesve të ri siguruesve nga paragrafi 5, pika b) të këtij neni në momentin e lidhjes së marrëveshjes nuk është më e madhe se 25% , por më vonë rritet në nivelin më të lartë se 25 % e jo më shumë se 30 % përjashtimi grupor do të vazhdon të zbatohet gjatë periudhës kalendarike prej dy vjetëve rresht pas vitit në të cilin për herë të parë është tejkualuar pjesëmarrja në treg e unionit të bashkë siguruesve të ri siguruesve prej 25%.

(11) Nëse pjesëmarrja e përgjithshme në treg e unionit të bashkë siguruesve të ri siguruesve nga paragrafi 5, pika b) të këtij neni në momentin e lidhjes së marrëveshjes nuk është më e madhe se 25% , por më vonë rritet në nivelin më të lartë se 30%, përjashtimi grupor do të vazhdon të zbatohet gjatë periudhës kalendarike prej një viti kalendarik pas vitit në të cilin për herë të parë është tejkualuar pjesëmarrja në treg e unionit të bashkë siguruesve të ri siguruesve prej 30 %.

(12) Përjashtimi grupor nga paragrafët 10 dhe 11 të këtij neni nuk mund të akumulohet në mënyrë që ta tejkalojë periudhën prej dy vjetëve kalendarik.

(13) Risku i ri në bazë të paragrafin 4-të të këtij neni konsiderohet risku i cili më parë nuk ka ekzistuar, dhe mbulimi i të cilit me sigurim mund të realizohet vetëm me kusht që të krijohet produkt tërësisht i ri i sigurimit, ose në rastet e veçanta, risku cilësitë e të cilit në bazë të analizës objektive aq shumë ka ndryshuar në aspektin material sa që nuk është e mundur për të ditur paraprakisht se çfarë vëllimi i mbulesës së dëmit është i nevojshëm për këtë nivel të riskut.

Plotësimi ose zëvendësimi i produktit ekzistues të sigurimi nuk konsiderohet risk i ri në kuptim të këtij udhëzimi administrativ.

### ***Përlllogaritja e pjesëmarrjes në treg***

#### **Neni 7**

(1) Pjesëmarrja në treg e unionit të bashkë siguruesve, ose e unionit të bashkë siguruesve të ri siguruesve nga neni 6, paragrafi 5 i këtij udhëzimi administrativ llogaritet në bazë të dhënave për të hyrat bruto të primit nga policat e sigurimit. Nëse të dhënat e bruto të hyrave nuk janë në dispozicion, me qëllim të përcaktimit të pjesëmarrjes në treg të palës në marrëveshje atëherë mund të përdoren edhe vlerësimet e bazuara në informacione të tjera të besueshme të tregut, duke e përfshirë edhe vlerën e sigurimit të mbuluar me polica të sigurimit ose vlerën e riskut të siguruar.

(2) Pjesëmarrja e tregut sipas paragrafit 1 të këtij neni do të llogaritet në bazë të dhënave që kanë të bëjnë me vitin kalendarik i cili i paraprin lidhjes së marrëveshjes.

### ***Kushtet e tjera të cilat duhet të përmbushen***

#### **Neni 8**

Përfshirimi grupor për unionet e bashkë-siguruesve ose unionet e bashkë-siguruesve të ri siguruesve nga neni 6 i këtij udhëzimi administrativ do të zbatohen me kusht që:

(a) Secili pjesëmarrës i marrëveshjes në një afat të arsyeshëm të ketë të drejtë të largohet nga unioni (fondi i përbashkët) pa pasur asnjë sanksion,

b) Rregullat e unionit, në tërësi ose në një pjesë, nuk e detyrojnë cilindo anëtar të unionit që nëpërmjet të unionit ta bëjë sigurimin apo ri sigurimin e cilit do lloj të riskut të cilin e mbulon unioni,

c) Rregullat e unionit, në tërësi ose në një pjesë, nuk e kufizojnë cilindo anëtar të unionit që jashtë unionit ta bëjë sigurimin ose ri sigurimin e cilit do lloj të riskut të cilin e mbulon unioni.

d) Rregullat e unionit nuk i kufizojnë aktivitetet e unionit ose të anëtarëve të saj për sigurim ose për ri sigurim të risqeve të cilat ndodhen në cilëndo pjesë të tregut relevant,

e) Marrëveshja të mos e kufizon shitjen,

f) Marrëveshja të mos i ndan tregjet, përkatësisht blerësit, dhe

g) Anëtarët e unionit të bashkë sigurimit të ri sigurimit të mos arrijnë marrëveshje lidhur me bruto primit e sigurimit të cilat i përlllogarisin në sigurimin e drejtpërdrejtë.

### **III. KUFIZIMET, PËRKATËSISHT KUSHTET TË CILAT MARRËVESHJET NUK GUXOJNË TI PËRMBAJNË**

#### **Neni 9**

Përfashtimet grupore të parashikuara me nenin 3 të këtij të udhëzimit administrativ nuk do të zbatohen kur palët arrijnë marrëveshje ndërmjet tyre, ia imponojnë kompanive të tjera ose i detyrojnë kompanitë e tjera që të mos i përdorin të dhënat përmbledhëse ose tabelat të cilat dallohen nga të dhënat e përbashkëta ose tabelat e hartuara (të përcaktuara) sipas nenit 3 paragrafi 1, pika a) e këtij udhëzimi administrativ, ose të mos largohen (shmangen) nga rezultatet e studimit në kuptim të nenit 3, paragrafi 1, pika b) të këtij udhëzimi administrativ.

### **IV. REVOKIMI I PËRJASHTIMIT GRUPOR**

#### ***Kushtet për revokimin e përjashtimit grupor***

#### **Neni 10**

(1) Autoriteti Kosovar i Konkurrencës në përputhje me nenin 4, paragrafi 4 të Ligjit nr. 04/L-226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës do ta fillojë vlerësimin e marrëveshjeve individuale të sigurimit, edhe pse ajo marrëveshje i plotëson kushtet për lirim grupor sipas këtij udhëzimi administrativ, në rastin kur efektet e asaj marrëveshje, individualisht ose në kombinim me marrëveshjet e ngjashme në tregun relevant, gjatë kohës sa ato janë në fuqi, bashkërisht (në mënyre kumulative) nuk i plotësojnë kushtet për lirim grupor sipas nenit 5, 6 dhe 7 të ligjit bazik (Ligjit nr.03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës).

(2) Nëse Autoriteti Kosovar i Konkurrencës gjatë procedurës për vlerësim të marrëveshjeve individuale nga paragrafi i 1 i këtij neni e vërteton se marrëveshja ka efekte të cilat janë në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në nenet 5, 6 dhe 7 të ligjit bazik (Ligjit nr.03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës) dhe të këtij udhëzimi administrativ, me Vendim do të heq (anuloj) përjashtimet grupore për atë marrëveshje.

#### ***Përcaktimi i dëshmive për plotësimin e kushteve lidhur me përjashtimin grupor të marrëveshjeve të sigurimit***

#### **Neni 11**

(1) Për marrëveshjet e sigurimit të cilat i përmbushin kushtet për përjashtim grupor nga ky udhëzim administrativ, zakonisht supozohet se i përmbushin kushtet nga nenet 5, 6 dhe 7 të ligjit bazik (Ligjit nr.03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës), përveç rasteve nga neni 10 i këtij udhëzimi administrativ.

(2) Përjashtimisht, marrëveshjet e sigurimit të cilat nuk i plotësojnë kushtet për përjashtim grupor sipas këtij udhëzimi administrativ, pjesëmarrësit e marrëveshjeve të tilla,



duhet vetë ta vlerësojnë nëse marrëveshjet e tyre, pavarësisht këtij fakti a i plotësojnë kushtet, për lirim (përjashtim) nga ndalimi i përgjithshëm i marrëveshjeve të përmendura në nenin 4 paragrafi 3 të ligjit nr.04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës.

(3) Nëse Autoritetit Kosovar i konkurrencës e fillon (inicion) procesin e vërtetimit të marrëveshjes së ndaluar duke ju referuar paragrafit të 2 të këtij neni, atëherë detyrimi për përcaktimin e dëshmive për përmbushjen e kushteve për përjashtim grupor sipas nenit 4, paragrafi 3 të ligjit nr.04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-229 për mbrojtjen e konkurrencës bie mbi kompanitë të cilat janë pjesëmarrëse të marrëveshjeve të tilla të sigurimit.

## **V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 12**

1. Në Marrëveshjet e sigurimit të cilat janë të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ dhe të cilët i kanë plotësuar kushtet për përjashtim grupor nga neni 4 paragrafi 3 të ligjit nr.04/L- 226 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-229 do të vazhdojnë të zbatohen dispozitat e ligjit të përmendur.

2. Marrëveshjet sigurimeve për përjashtimet grupore ndërmjet ndërmarrësve duhet të harmonizohen plotësisht me dispozitat e kësaj Rregullore.

3. Hasja në vështirësi gjatë aplikimit të dispozitave të kësaj Rregulloreje apo mungesa e dispozitave për marrjen e vendimit përfundimtar, duhet të aplikohen dispozitat e ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Plotësim ndryshimit të Ligjit 04/L-226, ligjit për procedurën e përgjithshme administrative dhe ligjet tjera që kanë të bëjnë me shkeljen e rregullave të konkurrencës.

### **Neni 13**

Ndryshimin dhe plotësimin e kësaj Rregulloreje mund ta propozojë çdo anëtar i Komisionit, e cila bëhet në mënyrën dhe procedurën e paraparë për miratimin e saj.

### **Neni 14**

Hyrja në fuqi

### **Neni 15**

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi në ditën e aprovimit të tij nga Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

KOMISIONI I  
AUTORITETIT KOSOVAR TË KONKURRENCËS

(\_\_\_\_\_)

Valon Prestreshi  
Kryetar

(\_\_\_\_\_)

Ahmet Krasniqi  
Zëvendëskryetar

(\_\_\_\_\_)

Fatime Haziri  
Anëtare

(\_\_\_\_\_)

Muhamed Krasniqi  
Anëtar

(\_\_\_\_\_)

Shaqir Morina  
Anëtar